

Lista e kurseve të ofruara nëpërmjet programit CETPM/IMET”, për vitin fiskal 2014.

ANEKS A

Nr.	Periudha	Titulli I Kursit	Kuotat	Kriteret	Pershkrimi I Kursit	Afati
1	26 Shtator 2014 -15 Dhjetor 2014	Programi i Studimeve të Aplikuara të Sigurisë/ Program in Applied Security Studies (PASS)	1 kuote	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë; Grada → Toger – Major / Civil ekuivalent	Pershkrimi: Programi siguron edukim të nivelit të lartë në çështjet e politikës së sigurisë, të mbrojtjes, marrëdhënieve ndërkombëtare, ligjit ndërkombëtar, luftës kundër krimit, korrupsionit dhe trafikimit njerëzor dhe të drogës.	Jo me vone se 25 Prill 2014
2	16-Korrik-08-Gusht-2014	Aspektet ligjore të mbështetjes me burime të mbrojtjes në rastet e emergjencave civile	1 kuote	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë; Grada → e pa përcaktuar; Të tjera → rekomandohet që personeli i propozuar për ndjekjen e këtij kursi të kryej detyra në shtab, planifikim, këshilltar ligjor ose detyra komanduese	Pershkrimi: Ky kurs tre javor promovon mbështetjen e autoriteteve civile nëpërmjet burimeve të mbrojtjes në përputhje me parimet demokratike të rregullave dhe ligjeve në fuqi, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe përdorimi i forcës në mënyrë të arsyeshme. Kursi do të prezantojë mekanizmat ndërkombëtarë ligjorë për dhënien e ndihmës humanitare në mënyrë më të mirë të pranueshme dhe në kohën e duhur, për ato vende të cilat janë goditur nga fatkeqësia natyrore. Qëllimi i kursit është të promovojë përdorimin e burimeve të mbrojtjes me përgjegjësi dhe efikasitet, në mbështetje të forcave të policisë dhe autoriteteve të menaxhimit të emergjencave civile, si dhe të rrisë kapacitetet e vendeve partnere për planifikimin dhe marrjen e asistencës së nevojshme në rastet e një fatkeqësie natyrore, nga Shtetet e Bashkuara dhe nga vendet e tjera donatore.	Jo me vone se 22 Maj 2014
3	30-Gusht-12-Shtator-2014	Veprimet Civilo-Ushtarake në luftën kundër terrorizmit	1 kuote	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë; Grada → Major-Kolonel / Civil ekuivalent	Qëllimi i këtij kursi është që të mbështesë këndvështrimin ndërkombëtar të komponentëve politik dhe ushtarak në luftën ndërkombëtare kundër terrorizmit, si dhe të rrisë kapacitetet e partnerëve të koalicionit për zhvillimin e programeve afat-shkurtra dhe afat-gjata për të luftuar terroizmin. Programe të qëndrueshme dhe në përputhje me principet demokratike. Ky kurs ofron një panoramë të plotë të të gjitha formave të terrorizmit me një theks të vecantë në formulimin e strategjisë dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.	Jo me vone se 22 Maj 2014
4	01-Shtator 21-Nentor-2014	Kursi I shtabeve të bashkuara.	1 kuote	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë; Grada → Major-Kolonel; Të tjera → të kenë përfunduar “Kursin e komandës dhe shtabit të përgjithshëm ose kurse të tjera ekuivalente jashtë vendit; pjesëmarrësit duhet të zotërojnë mirë gjuhën angleze dhe të jenë të jenë të aftë për të mbajtur prezantime mbi misionin, kapacitetet dhe eksperiencën e tyre në Forcat e Armatosura;	Kursi siguron studimin mbi strukturat e bashkuara dhe të ndërthurura, planëzimin dhe operacionet, aspektet që lidhen me sigurinë kombëtare e ndërkombëtare me qëllim përgatitjen e pjesëmarrësve për të shërbyer në komanda të bashkuara. Në veçanti tematika do të përmbajë parimet dhe konceptin themelor të strukturës së komandës së unifikuar të SHBA, organizimin, përbërjen dhe funksionet e një komande të bashkuar, planëzimi në nivel operacional, procesi i vendim marrjes ushtarake etj.	Jo me vone se 22 Maj 2014

Lista e kurseve të ofruara nëpërmjet programit CETPM/IMET”, për vitin fiskal 2014.

ANEKS A

Nr.	Periudha	Titulli I Kursit	Kuotat	Kriteret	Pershkrimi I Kursit	Afati
5	08-Dhjetor-2014-07-Korrik-2015	MANEUVER CCC/Kursi i Kapitenit të Karrierës të Këmbësorisë	1 kuote	Niveli i gjuhës → anglisht 75 pikë; Grada →Toger -Kapiten; mos ketë përfunduar KTHOSH. Certifikatë sigurie niveli “Sekret”	Të Pershkrimi: Kursi është projektuar për togerë dhe kapitenë të rinj për të shërbyer në pozicionet e komandantit të kompanisë dhe oficerit të shtabit në batalione. Kursi është i ndarë në tre faza: Faza e parë trajnim/administrim; Faza e dytë në nivel kompanie; Faza e tretë në nivel batalioni.	Jo me vone se 08 Korrik 2014
6	29-Dhjetor-2014-26-Qershor-2015	MIL POL CCC/Kursi i Kapitenit të Karrierës të Oficerit të Policisë Ushtarake	1 kuote	Niveli i gjuhës → anglisht 75 pikë; Grada →Toger -Kapiten; mos ketë përfunduar KTHOSH. Certifikatë sigurie niveli “Sekret”	Të Pershkrimi: Kursi fokusohet në zgjerimin dhe zhvillimin e vlerave profesionale si njohuritë drejtuese, taktike dhe teknike, etika ushtarake. Kursi përfshin trajnimin mbështetur në disa fusha kryesore si: dimensionimi human, sjellja, puna në grup dhe udhëheqja.	Jo me vone se 08 Korrik 2014
7	29-Dhjetor-2014 -05-Maj-2015	INFANTRY BOLC/Kursi Baze i Oficerit te Kembesorise.	1 kuote	Niveli i gjuhës → anglisht 75 pikë; Grada → N/toger-Toger; Të tjera → Kursi nuk është i aplikueshëm për kandidatet femra; Kandidatët të jenë të përgatitur për përballimin e ngarkesës fizike	Pershkrimi: Kursi është përshtatshëm për oficerë të cilët shërbejnë në detyrat e komandantit të togës, oficer ekzekutiv kompanie. Kursi ofron njohuri mbi taktikën e përdorimit të armëve (doktrina taktike dhe operacione), aktivitetet shtabi (zbulimi, logjistika, menaxhimi i stërvitjes), tema të përgjithshme (drejtimi ushtarak) ndërlidhje, elektronikë etj. Kursi fokusohet në anën taktike dhe aspektet e lidershipit të oficerëve të rinj dhe më pak në anën administrative. Pjesa më e madhe e kohëzgjatjes së kursit zhvillohet në terren. Gjithashtu kandidatit do të marrë njohuri mbi armatimin e lehtë që përdoret në togën e këmbësorisë së ushtrisë amerikane.	Jo me vone se 08 Korrik 2014
8	29-Dhjetor-2014 -01-Maj-2015	ORDINANCE BASIC LEADER OFF CRS/Kursi Bazë i Oficerit Ordiancë	1 kuote	Niveli i gjuhës → anglisht 75 pikë; Grada → Toger; Të jetë oficer i specialitetit Furnizim, Mirëmbajtje ose Armatim-Municion	Pershkrimi:Kursi ofron për pjesëmarrësit njohuri në: drejtim dhe udhëheqje, taktikat dhe mbrojtjen e njësisë, menaxhimin e mbështetjes dhe furnizimit të njësisë, mirëmbajtjen dhe mbështetjen e njësisë, menaxhimin e materialeve dhe municioneve.	Jo me vone se 08 Korrik 2014
9	30-Dhjetor-2014-05-Maj-2015	MIL INTEL BOLC/Kursi Bazë i Zbulimit Ushtarak	1 kuote	Niveli i gjuhës → anglisht 70 pikë; Grada → N/toger- Toger; Të tjera → Certifikatë sigurie niveli “B”;	Pershkrimi: Kursi ofron njohuri dhe aftësi bazë, të gjithë informacionin që i nevojitet një oficeri zbulimi në nivel taktik, si dhe njohurit dhe aftësitë që zotëron një oficer zbulimi në rolin e komandantit të togës . Kurrikula e kursit përfshin tema si; kërcënime të kundërshtarit, menaxhim i programit të stërvitjes së njësisë, sulmet elektronike, shërbimi inteligjent njerëzor, shërbimi inteligjent i ndërlidhjes, shërbimi inteligjent imazherik, mbështetja në operacioneve, kundërzbulim dhe shërbimi inteligjent në nivel taktik duke përdorur të gjitha burimet në dispozicion.	Jo me vone se 08 Korrik 2014

Kandidatet te cilet mendojne se plotesojne kriteret per ndjekjen e ketyre kurseve te ndjekin linjen e komandimit dhe nepermjet degeve te personelit te reparteve perkatese te sjellin propozimet ne Drejtorine e Arsimit dhe Perkuqdesjes Sociale te Ushtarakeve.

Të gjitha propozimet duhet të shoqërohen me dokumentacion përkatës (CV, përshkrim pune, formular me të dhënat personale në gjuhën angleze dhe fotokopje e pasaportës).